



## Shtyhet thirrja për Mobilitete (Bursa) Studentësh të UPT-së në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në University of Applied Sciences në Nysa, Poloni

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është shtyrë dhe ndyshuar thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në University of Applied Sciences në Nysa, Poloni.

### Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.
- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

### Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor, në Universitetin Politeknik të Tiranës. Të kenë përfunduar një vit akademik, Bachelor, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës.)
- **Master** (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës).

### Kohëzgjatja e bursave:

- Për studentë: 5 muaj, 1 semestër, spring 2021

### Fushat e studimit:

Arkitekturë, Inxhinieri Ndërtimi

**Numri total i studentëve në Bachelor, Master: 3 studentë**

### Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.



### **Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Master:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash të studimeve Bachelor;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Listë notash e studimeve Master, deri në momentin e aplikimit;
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;
- Dokumenti Learning Agreement\*\*.

*\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën është B1. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

*\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Applied Sciences In Nysa, Poloni, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës. Dokumenti "Learning Agreement" te seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

*Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni më poshtë:*

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement\\_en](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en)

*Për të parë listën e lëndëve dhe për të marrë informacion të përgjithshëm rreth studimeve në Applied Sciences In Nysa, Poloni klikoni **këtu**.*

<http://www.pwsz.nysa.pl/index.php?p=25,223,0,0,38,0>

***Afati për aplikim për studentët: deri më 23 dhjetor 2020, ora 13.00***

Aplikimi kryhet pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: [zyraekarrieres@upt.al](mailto:zyraekarrieres@upt.al)